



UJI I (PA) PIJSHËM I TIRANËS

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2024



QENDRESA QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
SERONA KOLAVERI

Përmbajtja

1. HYRJE	2
2. METODOLOGJIA	3
3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	3
1. Humbjet e ujit:.....	5
2. Ndërprerjet e shpeshta të furnizimit:.....	5
3. Depozitat e ujit dhe problemet me cilësinë:	5
4. Keqmenaxhimi institucional:	5
5. Kriza e furnizimit me ujë në verë:	6
6. Korrupsioni dhe tenderat:	6
4. SITUATA AKTUALE	8
Këndvështrimi mbi problemin	8
Pasojat Sociale dhe Shëndetësore	8
Nevoja për Ndërhyrje	9
5. PROBLEMATIKAT ME FURNIZIMIN ME UJË NË PERCEPTIMIN QYTETAR ...	9
GJETJET KRYESORE	21
REKOMANDIME	23



1. HYRJE

Mungesa e ujit të pijshëm është një prej sfidave kryesore me të cilat përballen qytetet në zhvillim të shpejtë, përfshirë Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë. Në vitin 2024, furnizimi me ujë të pijshëm vazhdon të jetë një problem thelbësor për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Tiranës, veçanërisht në zonat periferike. Rritja e popullsisë, urbanizimi intensiv dhe infrastruktura e vjetëruar janë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në përkeqësimin e situatës. Për më tepër, ndryshimet klimatike dhe mungesa e investimeve të qëndrueshme në burimet dhe rrjetet e kanalizimit të ujrave kanë përshkallëzuar problemin, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për të gjithë banorët.

Tirana është një qendër me rëndësi kombëtare dhe rajonale, jo vetëm për numrin e madh të banorëve të saj, por edhe për rolin që luan si një nyje kryesore për ekonominë dhe turizmin. Sidoqoftë, mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me ujë "kërcënon" përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Zona të mëdha urbane brenda dhe përreth qytetit po përballen me ndërprerje të shpeshta të ujit, sidomos gjatë periudhës së verës, kur kërkesa rritet dhe furnizimi është më i pamjaftueshëm.

Krahas ndikimit mbi jetën e përditshme të qytetarëve, mungesa e ujit të pijshëm sjell pasoja të mëdha për sektorin e turizmit dhe për industrinë në tërësi, duke ndikuar në mënyrë negative në përvojën e vizitorëve dhe duke ulur cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga bizneset lokale. Për më tepër, një furnizim i parregullt me ujë ndikon negativisht në shëndetin publik, duke shtuar rrezikun e përhapjes së sëmundjeve të lidhura me higjienën e pamjaftueshme dhe kontaminimin e ujit.

Ky raport synon të ofrojë një analizë të detajuar mbi situatën aktuale të furnizimit me ujë të pijshëm në Tiranë, të identifikojë faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë problem dhe të paraqesë rekomandime për zgjidhje të qëndrueshme që mund të përmirësojnë situatën në të ardhmen. Raporti përqendrohet në efektet e kësaj mungese, jo vetëm mbi qytetarët, por edhe mbi mjedisin dhe zhvillimin ekonomik të qytetit.



2. METODOLOGJIA

Raporti mbështetet në metoda cilësore dhe sasiore për mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë:

- **Anketime:** Grumbullimi i të dhënave me qytetarët e Bashkisë Tiranë përmes pyetësorëve për të vlerësuar ndikimin e drejtpërdrejtë të mungesës së ujit.
- **Burime Institucionale:** Përdorimi i të dhënave nga bashkitë dhe organizatat ndërkombëtare që monitorojnë furnizimin me ujë.

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Situata me furnizimin e ujit në Shqipëri është përkeqësuar në vitet e fundit, veçanërisht për shkak të mungesës së investimeve. Në shumë zona, furnizimi i ujit është i kufizuar, ndërsa oraret e furnizimit janë të reduktuara. Nga të dhënat e analizuara problematika me mungesën e ujit të pijshëm dhe nivelin e dobët të cilësisë së tij rezulton që prej vitit 2003 deri në ditët e sotme.

2003-2010: Mungesa e Investimeve dhe Keqmenaxhimi i Burimeve

Në vitet e para të kësaj periudhe, qeveria shqiptare e pati të pamjaftueshme angazhimin në investime për përmirësimin e infrastrukturës së ujit. Projektet për rinovimin e rrjeteve të ujit shpesh ishin të kufizuara dhe të paefektshme për shkak të planifikimit të dobët dhe mungesës së financimit adekuat. Keqmenaxhimi i burimeve ujore ishte i dukshëm dhe shumë projekte mbetën të pasuksesshme për shkak të korrupsionit dhe shpërdorimeve në tendera. Këto deficite e bënë sistemin të papërgatitur për t'u përballur me rritjen e kërkesës për ujë. Gjatë periudhës 2003-2010, Shqipëria u përball me probleme serioze në sektorin e furnizimit me ujë, që preknin kryesisht qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, dhe Fieri, ndërsa infrastruktura e vjetër dhe keqmenaxhimi ishin ndër faktorët kryesorë të këtyre problemeve.ⁱ

1. Infrastruktura e vjetëruar: Sistemet e furnizimit me ujë, të ndërtuara kryesisht gjatë regjimit komunist, ishin në gjendje të rënduar, duke mos



përballuar më kërkesat e popullsisë në rritje pas viteve '90.ⁱⁱ Përveç kësaj, mungesa e përmirësimeve të infrastrukturës kishte bërë që tubacionet dhe stacionet e pompimit të ishin të prishura ose jashtë funksionit, duke çuar në ndërprerje të shpeshta të furnizimit. Kjo periudhë u shënua nga përpjekjet për të rehabilituar disa zona të mëdha urbane, si pjesë e projekteve të Bankës Botërore, por këto përpjekje shpesh ishin të pamjaftueshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.

2. Menaxhimi i dobët: Problemet e menaxhimit në ndërmarrjet e ujësjellësit çuan në një keqkoordinim të burimeve dhe në mungesën e investimeve të qëndrueshme për të adresuar humbjet në rrjetin e ujësjellësit. Për më tepër, ndërmarrjet shpesh kishin vështirësi në mbledhjen e të ardhurave nga faturimet e konsumatorëve, gjë që e përkeqësoi më tej situatën financiare të sektorit.

3. Shpërdorimi dhe humbjet e ujit: Në këtë periudhë, humbjet e ujit ishin të larta për shkak të rrjedhjeve të shumta dhe mungesës së mirëmbajtjes së duhur të tubacioneve. Banka Botërore raportoi se disa qytete, përfshirë Tiranën, humbnin deri në 70% të ujit të prodhuar nëpër rrjet për shkak të infrastrukturës së dëmtuar.

4. Cilësia e ujit dhe ndotja: Cilësia e ujit shpesh nuk përputhej me standardet ndërkombëtare për shkak të ndotjes së burimeve të ujit dhe mungesës së teknologjisë së filtrimit dhe trajtimit. Mungesa e rregullimeve për mbrojtjen e burimeve të ujit nga ndotja industriale dhe bujqësore ndikoi drejtpërdrejt në cilësinë e ujit që arrinte tek qytetarët.

5. Mungesa e depove dhe rezervuarëve: Ndërtesat e reja të ndërtuara gjatë kësaj periudhe shpesh nuk ishin të pajisura me depozita uji, duke i bërë ato të varura nga furnizimi publik, i cili përjetonte ndërprerje të shpeshta. Shumë ndërtesa të vjetra kishin depozita që nuk pastroheshin rregullisht, çka rrezikonte cilësinë e ujit që përdorej nga banorët.

2010-2015: Reforma të Pjesëshme dhe Shpërndarja e Fondeve

Gjatë kësaj periudhe, qeveria përpiqej të implementonte reforma për të përmirësuar furnizimin me ujë, por këto reforma u shoqëruan me probleme të theksuara. Shpërndarja e fondeve për projekte



infrastrukturore ishte e paefektshme dhe zbatimi i tyre shpesh ishte i ngadaltë dhe i papërgjegjshëm. Keqmenaxhimi në tendera dhe ndarjet e fondeve për projekte të dyshimta ndihmuan në përkeqësimin e krizës, duke e bërë furnizimin me ujë të papërmirësuar dhe të pasigurt. Gjatë periudhës 2010-2015, furnizimi me ujë në Shqipëri vazhdoi të përballej me sfida të mëdha, me shumë probleme të mbetura nga vitet e mëparshme dhe disa situata që u përkeqësuan.ⁱⁱⁱ

1. Humbjet e ujit:

Një problem madhor mbeti humbja e ujit përmes rrjetit të vjetëruar dhe të dëmtuar. Edhe gjatë kësaj periudhe, rreth 50-60% e ujit të prodhuar humbej përmes rrjedhjeve dhe vjedhjes. Keqmenaxhimi i rrjetit kontribuoi në pamundësinë për të furnizuar në mënyrë të qëndrueshme disa rajone, përfshirë kryeqytetin.^{iv}

2. Ndërprerjet e shpeshta të furnizimit:

Mungesa e ujit për disa orë në ditë ishte një realitet i përditshëm për shumë zona të Tiranës dhe qytete të tjera. Qytetarët përballeshin me ndërprerje të shpeshta të furnizimit për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe pamundësisë së rrjetit për të mbuluar kërkesën në rritje. Në zonat periferike dhe ato rurale, furnizimi me ujë shpesh ishte i kufizuar në disa orë gjatë ditës.

3. Depozitat e ujit dhe problemet me cilësinë:

Shumë ndërtesa, sidomos pallatet e ndërtuara pas viteve 2000, nuk ishin të pajisura me depozita uji, duke u varur vetëm nga furnizimi publik, që shpesh ishte i parregullt. Edhe në ato ndërtesa që kishin depozita, pastërtia dhe mirëmbajtja e tyre shpesh ishte e pakontrolluar, duke shkaktuar rrezik për cilësinë e ujit. Mungesa e filtrimit dhe ndotja industriale e burimeve të ujit përkeqësoi më tej situatën.

4. Keqmenaxhimi institucional:

Ndërmarrjet e ujësjellësit dhe kanalizimeve vazhduan të përballeshin me probleme financiare dhe mungesë të investimeve të qëndrueshme, duke përkeqësuar situatën e furnizimit me ujë. Politikat e fragmentuara



dhe ndryshimet e shpeshta në administratë kontribuan në mosfunksionimin e projekteve të mëdha për përmirësimin e furnizimit.

5. Kriza e furnizimit me ujë në verë:

Për shkak të rritjes së temperaturave dhe sezonit turistik, gjatë muajve të verës, krizat e furnizimit u përkeqësuan. Ndërprerjet e furnizimit ishin të shpeshta në qytete bregdetare si Durrësi dhe Vlora, ku kërkesa për ujë rritet ndjeshëm gjatë sezonit të verës.

6. Korrupsioni dhe tenderat:

Shpesh herë, tenderat për projektet e ujësjellësit u shoqëruan me akuzime për korrupsion dhe menaxhim të dobët. Kjo përkeqësoi situatën, duke çuar në shpërdorim të fondeve publike dhe projekte të papërfunduara ose të cilësisë së dobët.

2015-2020: Ndikimi i Politizimit dhe Korrupsionit

Në këtë periudhë, politizimi i sektorit të ujit u rrit ndjeshëm, duke penguar përpjekjet për zgjidhjen e krizës. Qeveria shpesh e përdorte sektorin e ujit si një mjet për të fituar popullaritet politik, duke përfshirë projekte që ishin më shumë simbolike sesa funksionale. Korrupsioni i përhapur dhe ndikimi politik në menaxhimin e burimeve ujore kontribuan në shfaqjen e problemeve të tjera infrastrukturore. Këto praktika keqmenaxhuese thelluan ndjeshëm krizën e ujit dhe krijuan një situatë të pasigurt për qytetarët.

Gjatë periudhës 2015-2020, furnizimi me ujë në Shqipëri përjetoj përkeqësime për shkak të keqmenaxhimit të qeverisë dhe mungesës së investimeve adekuate në sektorin e ujësjellësit. Problemet kryesore përfshinin:

Menaxhimi i dobët i projekteve: Qeveria shqiptare dështoi në zbatimin e projekteve të mëdha për përmirësimin e infrastrukturës ujore. Në disa raste, fondet e dedikuara për përmirësimin e rrjetit të furnizimit u devijuan ose u përdorën në mënyrë joefikase. Ndërprerjet e furnizimit mbetën një problem i madh në qytete si Tirana dhe Durrësi, ku shumica e banorëve mbështeteshin në depozitat private për furnizim bazik.

Mungesa e planeve afatgjata: Megjithëse qeveria shpalli plane për përmirësimin e infrastrukturës, shumë prej tyre mbetën në faza teorike ose u implementuan pjesërisht, duke krijuar një boshllëk mes kërkesës dhe kapacitetit për furnizimin me ujë. Kjo dobësi administrative ndërlikoi edhe më tej krizën e ujit, sidomos në periudha thatësirash të gjata.

Ndikimi i faktorëve klimatikë dhe mungesa e reagimit institucional: Ndryshimet klimatike, si reshjet e pakta dhe temperaturat e larta, ulën ndjeshëm rezervat ujore, sidomos në veri të vendit. Qeveria nuk arriti të adresonte këto sfida me politika të përshtatshme, duke lënë sektorin energjetik, i cili mbështetet te hidrocentralet, të ekspozuar ndaj rrezikut të ndërprerjeve.

2020-2024: Shpërndarja e Dështuar e Burimeve dhe Problematikat Politike

Në vitet e fundit, qeveria ka vazhduar të ndeshet me kritika për mënyrën si ka menaxhuar burimet ujore dhe ka shpërndarë fonde. Shpërndarja e burimeve për projekte të rëndësishme për përmirësimin e furnizimit me ujë shpesh ka qenë e paefektshme dhe menaxhimi politik i dobët ka çuar në zvarritje të projekteve ku shumica rezultojnë të pasuksesshme. Politizimi dhe korrupsioni i përhapur kanë ndikuar negativisht në përpjekjet për të zgjidhur problemin e mungesës së ujit, duke e bërë situatën gjithnjë e më të rëndë për qytetarët dhe bizneset.

Gjatë periudhës 2020-2024, Shqipëria vazhdoi të përballet me sfida të konsiderueshme në sektorin e furnizimit me ujë. Një nga problemet kryesore ishte menaxhimi i dobët nga ana e qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse, që u reflektua në mungesën e investimeve efikase dhe në infrastrukturën e vjetëruar. Në vitin 2021, qeveria nënshkroi një marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve për një kredi prej 80 milion eurosh për modernizimin e rrjetit të furnizimit me ujë në Tiranë, megjithatë kjo nuk ishte e mjaftueshme për të adresuar problemet strukturore që preknin jo vetëm kryeqytetin, por të gjithë vendin.^v

Raportet e autoriteteve treguan se shumë nga ujësjellësit kishin probleme me cilësinë e ujit dhe shërbimin, duke e bërë të vështirë për

qytetarët të marrin ujë të pijshëm të sigurt dhe me norma të pranueshme.

Problemet me ndotjen e burimeve të ujit dhe ndërtimi i depozitave të paefektshme u përkeqësuan më tej nga mungesa e strategjive të qarta të menaxhimit dhe planifikimit urban, duke krijuar një situatë të mjerueshme për shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në vitin 2024, Shqipëria vazhdon të përballet me një krizë të thellë të furnizimit me ujë, e cila është rënduar nga keqmenaxhimi politik dhe dështimet në menaxhimin e burimeve dhe investimeve.

4. SITUATA AKTUALE

Në vitin 2024, mungesa e ujit në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë, është shndërruar në një problem serioz, duke prekur një numër të madh qytetarësh. Me mbi gjysmën e popullsisë që përjeton mungesë të ujit, ky fenomen është bërë një çështje kritike që kërkon vëmendjen urgjente të autoriteteve.

Këndvështrimi mbi problemin

Tirana, si qendër kryesore, po përballet çdo ditë e më shumë mungesën e ujit. Lagjet si Kombinat, Sauk, dhe Laprakë janë përfshirë nga ndërprerje të shpeshta, duke shkaktuar periudha që shkojnë deri në një muaj pa ujë.

Investimet e Gabuara dhe Keqmenaxhimi: Pavarësisht investimeve të shumta dhe tenderave që arrijnë në miliona euro, shumë qytetarë dyshojnë se këto para janë keqpërdorur. Kjo situatë ka çuar në humbjen e besimit tek autoritetet, ndërsa qytetarët vazhdojnë të përballen me kushte të papranueshme.

Pasojat Sociale dhe Shëndetësore

Mungesa e ujit ka pasoja të rënda në shëndetin publik. Rritja e infeksioneve dhe sëmundjeve për shkak të mungesës së ujit të pastër është një rrezik i dukshëm, duke e bërë këtë situatë një emergjencë shëndetësore. Një numër i madh qytetarësh kanë shprehur shqetësime për cilësinë e ujit që po përdorin, duke theksuar se ai është i ndotur dhe i papërshtatshëm për konsum.



Nevoja për Ndërhyrje

Përballë kësaj situatë alarmante, është e qartë se kërkohet një angazhim i menjëhershëm nga autoritetet. Një auditim i plotë mbi investimet dhe përdorimin e fondeve është i nevojshëm për të siguruar që paratë e taksapaguesve po shpenzohen siç duhet dhe për të garantuar një furnizim të vazhdueshëm me ujë për të gjithë qytetarët.

Ndërkohë, thirrjet për një hetim nga SPAK mbi keqpërdorimet e mundshme dhe dështimet në menaxhim janë gjithnjë e më të pranishme. Qytetarët kërkojnë transparencë dhe përgjegjësi nga liderët e tyre, të cilët duhet të përballen me pasojat e dështimeve të tyre.

5. PROBLEMATIKAT ME FURNIZIMIN ME UJË NË PERCEPTIMIN QYTETAR


Perceptimin e qytetarëve për cilësinë e furnizimit me ujë në Bashkinë Tiranë e kemi analizuar përmes të dhënave të grumbulluara nga një pyetësor në të cilin morën pjesë **130** të anketuar.

I. MUNGESA E UJIT

Nga të dhënat rezulton se **15.4%** e të anketuarve përballen me mungesë të ujit çdo ditë dhe **20%** e tyre disa herë në javë. Kjo tregon se pavarësisht iniciativave të supozuara të




ndërmarra në përmirësimin e mungesës së ujit të pijshëm në Bashkinë Tiranë që prej vitit 2003 dhe deri në ditët e sotme problematika me ujin e pijshëm vazhdon të mbetet evidente .



Grafik 1: Mungesa e ujit (Përpunim i autorit)

Pavarësisht se qeveria vit pas viti ka theksuar ndërmarrjen e shumë iniciativave dhe projekteve lidhur me përmirësimin e kësaj problematike, përsëri nga të dhënat e grumbulluara vëmë re se propaganda dhe keqmenaxhimi politik prevalojnë mbi nevojat aktuale të qytetarëve dhe problematikat me të cilat përballet vendi sot .

II. KOHËZGJATJA E MUNGESËS SË UJIT



Grafik 2: Kohëzgjatja e mungesës së ujit (Përpunim i autorit)

Rezultatet e pyetësorit tregojnë një problem të vazhdueshëm me mungesën e ujit në Bashkinë Tiranë. Analiza e të dhënave të

grumbulluara tregon se **32.3% e të anketuarve** kanë mungesë uji për **2 deri në 4 orë**, ndërsa një përqindje e konsiderueshme prej **17.7%** përjeton mungesë

ujit për **4 deri në 8 orë**. Më shqetësuese është fakti që rreth **15%** e të anketuarve raportojnë mungesë uji për më shumë se **8 orë**, gjë që përbën një situatë kritike dhe të paqëndrueshme për një pjesë të madhe të popullsisë.

Këto shifra nënvizojnë një problem sistematik të infrastrukturës dhe menaxhimit të furnizimit me ujë. Ndërprerjet e zgjatura të furnizimit me ujë shkaktojnë probleme serioze për përditshmërinë e qytetarëve, duke rritur rrezikun për sëmundje dhe infeksione.


III.PAJISJA ME DEPOZITA PËR FURNIZIMIN ME UJË

Të dhënat e mësipërme tregojnë se **30%** e të anketuarve nuk kanë informacion për pajisjen e pallateve me depozita për furnizimin me ujë, ndërsa **15%** raportojnë se nuk kanë depozitë, gjë e cila përbën një problematikë që prek një pjesë të konsiderueshme të popullatës urbane. Kjo situatë reflekton jo vetëm mungesën e **komunikimit dhe transparencës** nga autoritetet për menaxhimin e ujit, por edhe **mosrealizimin** e një infrastrukture të domosdoshme për të përballuar ndërprerjet e furnizimit. Fakti që **një e treta** e qytetarëve nuk ka informacion për depozitat tregon një problem të rëndësishëm në zinxhirin e komunikimit midis **Bashkisë Tiranë** dhe banorëve. Një mungesë e tillë e informimit krijon **pasiguri** në komunitet dhe shpesh nxit **vetë-masa** si pajisja individuale me depozita private, duke krijuar

pabarazi mes atyre që kanë mundësi për këto masa dhe atyre që nuk mund t'i përballojnë.

Për ata që raportojnë mungesën e depozitave, sfidat janë më të mëdha.


15% e të anketuarve



Grafik 3: Pajisja me depozita për furnizimin me ujë

që jetojnë në pallate pa depozita përballen me ndërprerje të papritura të furnizimit me ujë. Kjo shkakton një ndërprerje të rëndësishme të aktivitetit të përditshëm, veçanërisht në stinët e nxehta ose në periudhat e rritjes së kërkesës për ujë. Ndërprerjet e zgjatura pa një alternativë të sigurtë si depozitat, përkeqësojnë cilësinë e jetës dhe rrisin varësinë nga **shërbimet alternative**. Nga kjo analizë, vërehet një **dështim** institucioneve lokale në krijimin e një sistemi të mirëmenaxhuar për të garantuar furnizim të vazhdueshëm me ujë. Përveç keqmenaxhimit të burimeve dhe fondeve publike për ujësjellësin, kjo situatë reflekton gjithashtu një **mangësi në planifikimin urban** të Tiranës. Projekte që përfshijnë ndërtimin e pallateve të reja duhet të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për ruajtjen e ujit, por mungesa e depozitave tregon se kjo **infrastrukturë** është shpesh injoruar ose lënë mënjanë.

IV. SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT LIDHUR ME PROCESIN E PASTRIMIT TË DEPOZITAVE



Grafik 4: Procesi i pastrimit të depozitave

Të anketuarit të pyetur lidhur me procesin e pastrimit të depozitave; 5.7 % e tyre shprehen se depozita në pallatin në të cilin ata jetojnë pastrohet 1 herë në 6 muaj, rreth 20% e tyre nuk pastrohet, 5.7% pastrohet 1 herë në vit dhe rreth 70% e të anketuarve shprehen se nuk


kanë fare informacion lidhur me pastrimin e depozitës së pallatit të tyre. Rezultatet e anketimit tregojnë një mungesë të theksuar informacioni dhe një praktikë të dobët në pastrimin e depozitave të ujit, që është një aspekt thelbësor për cilësinë e furnizimit me ujë të

pijshëm. Fakti që **70%** e të anketuarve nuk kanë informacion për procesin e pastrimit të depozitës së pallatit tregon një **pabarazi serioze në transparencë dhe ndërgjegjësimit publik**. Ky nivel i ulët i informimit rrezikon cilësinë e jetës së qytetarëve dhe tregon për një **mungesë të menaxhimit të mirë të infrastrukturës** ujore nga autoritetet lokale ose ndërmarrjet e ujësjellësit.

Në këtë kontekst, fakti që **20%** e të anketuarve konfirmojnë se depozitat nuk pastrohen fare është alarmant, pasi pastrimi i rregullt i depozitave është i domosdoshëm për të shmangur ndotjen dhe degradimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Mungesa e pastrimit çon në përhapjen e baktereve, kimikateve dhe substancave të dëmshme, duke rrezikuar shëndetin publik.

V. PËRDORIMI I UJIT TË RUBINETIT

Në vijim kemi matur përdorimin e ujit që vjen nga rubineti dhe nga të dhënat e grumbulluara rezultojnë se **9.2%** e të anketuarve e përdorin **për ta pirë** ; **31.5%** për të gatuar ; **90.8%** për të pastruar dhe **3.8 % nuk e përdorin**.



Grafik 5: Përdorimi i ujit


Të dhënat e grumbulluara mbi përdorimin e ujit nga rubineti reflektojnë një **mosbesim të theksuar** të cilësisë së tij si ujë i pijshëm. Fakti që vetëm **9.2%** e të anketuarve e përdorin ujin e rubinetit për ta pirë tregon një nivel të ulët të atyre që janë përdorues të shërbimit parësor që reklamojnë autoritetet lokale. Ky nivel i ulët përdorimi për konsum tregon që qytetarët, për shkak të cilësisë së dobët ose frikës nga ndotja, preferojnë alternativa të tjera si uji i ambalazhuar.

Nga ana tjetër, **31.5%** e përdorin për gatim, një tregues që qytetarët besojnë se përpunimi termik mund të përmirësojë cilësinë e ujit dhe ta bëjë të sigurt për përdorim. Kjo shifër tregon një **kompromis** nga ana e qytetarëve për të shmangur përdorimin e drejtpërdrejtë të ujit të rubinetit për konsum. Përdorimi masiv për pastrim, me **90.8%**, tregon që shumica e qytetarëve e shohin ujin e rubinetit të dobishëm vetëm për qëllime të tjera higjienike dhe jo për konsum. **3.8%** që nuk e përdorin fare reflekton që ka edhe një grup qytetarësh që ka arritur një nivel mosbesimi total, duke shmangur plotësisht çdo kontakt me ujin e rubinetit. Këto të dhëna theksojnë nevojën për **investime të domosdoshme** në përmirësimin e cilësisë së ujit të rubinetit dhe përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm.

VI. CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM TË MARRË NËPËRMJET RUBINETIT


Përsa i përket perceptimit të qytetarëve lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm, shifrat rezultojnë shqetësuese. Rreth 80% e të anketuarve shprehin se cilësia e ujit të pijshëm të marrë nëpërmjet rubinetit është e dobët; 13.1% e pranueshme, vetëm 7.1% e pranueshme, dhe për asnjë nga të anketuarit-shumë e mirë. Rreth **80%** të të anketuarve që e vlerësojnë cilësinë si të dobët, bëhet e qartë se uji i rubinetit konsiderohet i pasigurt për konsum. Kjo reflekton **probleme të theksuara infrastrukturore**, ku mungesa e filtrimit, kontaminimi dhe rrjedhjet e tubacioneve të vjetra mund të jenë faktorë kryesorë. Fakti që vetëm **13.1%** e shohin cilësinë si të pranueshme dhe vetëm **7.1%** si të kënaqshme, por asnjë nuk e cilëson ujin si shumë të mirë, tregon mungesë të plotë besimi të institucionet për ofrimin e një shërbimi të standardeve ndërkombëtare. Kjo situatë përforcon idenë se **përmirësimet e premtuara** në furnizimin me ujë dhe investimet e shumta të bëra nuk kanë dhënë rezultatet e pritshme. Kjo gjendje problematike mund të ndikojë **drejtpërdrejt në shëndetin dhe mirëqenien** e qytetarëve, duke i shtyrë ata të përdorin ujë të ambalazhuar për të shmangur rreziqet e ndotjes. Po ashtu, tregon nevojën për një **rishikim të prioriteteve** dhe transparencë mbi mënyrën sesi janë shpenzuar fondet e investuara në këtë sektor.





Grafik 6: Cilësia e ujit të pijshëm që merret nepermjet rubinetit

VII.SHPENZIME EKSTRA DHE SHPËRNDARJA MESATARE NË DITË PËR UJË TË PIJSHËM



Nga të dhënat rezulton se rreth 97% e të anketuarve shpenzon ekstra dhe vetëm 3.1 % e të anketuarve nuk shpenzon para për blerjen e ujit të pijshëm. Përlllogaritur mesatarisht në ditë shpenzimet konsistojnë ; 100-200 lekë (të reja) më shumë se 53% e të anketuarve , 200-300 lekë (të reja) rreth 31%, 300-400 lekë (të reja) rreth 12%, më shumë (se shifrat e lartpërmendura) 3.1% , dhe 0 leke vetem 1.5%. Analiza e të dhënave lidhur me shpenzimet e qytetarëve për blerjen e ujit të pijshëm në Tiranë përfshin disa dimensione që duhen shqyrtuar thellë, duke nxjerrë në pah ndikimet ekonomike, sociale dhe mungesën e zgjidhjeve afatgjata për problemin.

Grafik 7: Shpenzime ekstra për furnizimin me ujë të pijshëm


1. **Përqindja e lartë e shpenzimeve për ujë të pijshëm (97%):** Kjo shifër tregon një **dështim të sistemit publik të furnizimit me ujë** për të përmbushur nevojat bazë të qytetarëve. Në një shoqëri

moderne, qasja në ujë të sigurt duhet të jetë një e drejtë themelore, e garantuar nga qeveria dhe shërbimet publike. Megjithatë, **97% e popullatës** detyrohet të blejë ujë, ç'ka tregon një **mosbesim të thellë ndaj cilësisë së ujit nga rubineti**.

- 2. Shpenzimet ditore (100-200 lekë për më shumë se 53% të anketuarve):** Për shumë familje në Shqipëri, kjo shumë është një **ngarkesë e konsiderueshme financiare**, sidomos në kontekstin e pagave të ulëta dhe kostos së jetesës që është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Këto shpenzime mund të shihen si një **kosto e fshehur e dështimeve të politikave publike**, duke çuar në përkeqësimin e standardeve të jetesës për një numër të madh familjesh.
- 3. Rritja e varësisë nga uji i ambalazhuar:** Fakti që shumica e qytetarëve zgjedhin të blejnë ujë të pijshëm për shkak të mungesës së besimit në cilësinë e ujit të rubinetit tregon një **deficit të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe rregullimin e cilësisë së ujit të ofruar nga institucionet publike**. Kjo situatë shton varësinë nga furnizuesit privatë, duke i bërë qytetarët të varur nga **një sistem i dyfishtë**, ku uji për pastrim vjen nga rubineti, ndërsa për pirje blehet.
- 4. Shpenzimet mbi 300 lekë për 12% të anketuarve:** Për një pjesë të popullsisë që shpenzon më shumë se **300 lekë në ditë**, kjo tregon një **diskriminim të thelluar socio-ekonomik**, ku familjet me të ardhura më të ulëta janë ndoshta më të goditura nga kjo krizë e furnizimit me ujë. Shpenzimet më të larta mund të jenë rezultat i qasjes më të kufizuar në burime alternative të furnizimit me ujë, ose thjesht për shkak të numrit të lartë të personave në familje.
- 5. Vetëm 1.5% e qytetarëve nuk shpenzojnë për ujë të pijshëm:** Kjo shifër tregon se pothuajse të gjithë qytetarët kanë **mangësi në qasjen ndaj ujit të pijshëm të sigurt**. Vetëm një **përqindje shumë e vogël** mund të mbështetet tek sistemi i ujit publik ose ka akses në burime alternative si puse apo burime të sigurta. Kjo **përrjashton** një pjesë të vogël të popullsisë që nuk përballet me të njëjtën sfidë, duke vënë në dukje **pabarazitë** në aksesin e burimeve të nevojshme për jetesë.
- 6. Ndikimet ekonomike afatgjata:** Ky nivel i shpenzimeve ka një **impakt të drejtpërdrejtë në buxhetin familjar**, duke krijuar një shtytje për **barriera më të mëdha financiare** në përbalimin e




nevojave të tjera bazike si energjia, ushqimi, dhe strehimi. Gjithashtu, në një nivel makroekonomik, përdorimi i parasë për shpenzime mbi ujë në vend që të alokohet për konsum apo kursime të tjera, mund të ketë një **ndikim negativ në ekonominë vendore.**



Grafiku 8: Shpenzime mesatare në ditë për ujë të pijshëm

VIII.VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË KOMUNIKIMIT TË INSTITUCIONEVE



Grafik 9: Komunikimi i institucioneve për mungesat e ujit dhe kohën e zgjidhjes së tyre

Analiza e të dhënave mbi vleresimin e qytetarëve në lidhje me komunikimin institucional mbi mungesat e ujit tregon një krizë të thellë të besimit dhe transparencës mes institucioneve dhe popullatës. 43.8% shumë të pakënaqur nga komunikimi i institucioneve për mungesat e ujit dhe kohën e zgjidhjes së tyre; të kënaqur 13.1% ; të pakënaqur rreth 37% dhe shumë të kënaqur vetëm 0.1%.



1. **Shumë të pakënaqur (43.8%):** Kjo shifër tregon një **mosbesim të madh** të qytetarëve ndaj mënyrës se si institucionet vendore trajtojnë dhe komunikojnë situatën e mungesës së ujit. Kjo mund të lidhet me **mungesën e informacionit të qartë**, transparencën e dobët, dhe **mosrespektimin e afateve** të premtuara për zgjidhje. Një mungesë e tillë e informacionit kontribuon në pakënaqësinë e qytetarëve që nuk ndihen të përfshirë në zgjidhjen e problemeve të tyre bazike.
2. **Të pakënaqur (37%):** Kjo përqindje gjithashtu thekson një **nivel të lartë të zhgënjimit**, por më të moderuar në krahasim me shifrat e mesiperme. Këta qytetarë mund të kenë pasur disa **përmirësime të vogla në komunikimin institucional**, por ende ndejnë se nuk është mjaftueshëm për të përmbushur pritshmëritë e tyre.
3. **Të kënaqur (13.1%):** Kjo përqindje e vogël tregon se ka një **minoritet qytetarësh** që kanë përjetuar një komunikim më të efektshëm dhe të qartë nga institucionet. Kjo mund të lidhet me **qasjen më të mirë në informacione** në disa zona ose me **më shumë ndërveprim lokal** për zgjidhjen e problemeve të tyre.
4. **Shumë të kënaqur (0.1%):** Ky rezultat ekstremisht i ulët nxjerr në pah se pothuajse asnjë qytetar nuk e sheh komunikimin institucional si **të shkëlqyeshëm ose të mjaftueshëm**, duke vënë në pikëpyetje **efektivitetin e strategjive të komunikimit** të përdorura nga institucione

IX.NIVELI I INFORMIMIT LIDHUR ME PROJEKTET E INSTITUCIONEVE PËR PËRMIRËSIMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM


Lidhur me shpërndarjen e informacionit për projektet e institucioneve për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm rezultojnë se 65.4% e të anketuarve nuk janë fare të informuar; 30.8% pak të informuar dhe vetëm 3.8% të informuar. Analiza e shpërndarjes së informacionit lidhur me projektet e institucioneve për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm tregon një situatë shqetësuese për komunikimin institucional dhe transparencën:

1. **65.4% nuk janë fare të informuar:** Kjo shifër dëshmon një **mungesë të thellë të komunikimit** nga ana e institucioneve. Një shumicë e konsiderueshme e qytetarëve ndejnë se nuk kanë qasje në informacionin esencial për projektet që lidhen me ujë,

ç'ka tregon për një **neglizhencë të qeverisjes** në informimin e publikut. Kjo situatë jo vetëm që rrit nivelin e frustrimit mes qytetarëve, por gjithashtu nxit një ndjenjë të mosbesimit ndaj institucioneve.


2. **30.8% pak të informuar:** Edhe pse një përqindje e vogël ka ndonjë informacion, e cila tregon se disa qytetarë kanë akses në informacionin e projektit, ndjenja e pasigurisë dhe e pamjaftueshmërisë së njohurive mbetet e fortë. Ky grup ndoshta ka marrë disa njoftime, por ato janë **të pamjaftueshme** për t'i bërë ata të ndihen të sigurt dhe të informuar plotësisht për çështjet që i prekin drejtpërdrejt.
3. **3.8% të informuar:** Kjo shifër ekstremisht e ulët tregon se vetëm një numër shumë i vogël qytetarësh është në dijeni të plotë për projektet e përmirësimit të furnizimit me ujë. Kjo situatë pasqyron një **dështim të institucioneve për të angazhuar dhe përfshirë qytetarët** në mënyrë efektive në proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit të projekteve.

Përfundimisht, këto të dhëna theksojnë nevojën për **përmirësim të menjëhershëm në komunikimin institucional**. Institucionet duhet të angazhohen në mënyrë aktive për të siguruar që qytetarët të kenë akses në informacionin e nevojshëm dhe të jenë të përfshirë në diskutimet për politikatat që ndikojnë në jetën e tyre.



Grafik 10: Shpërndarja e informacionit për projektet e institucioneve për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm.

X. VLERËSIMI I PUNËS SË BASHKISË TIRANË



Grafik 11: Vlerësimi i punës së Bashkisë Tiranë në adresimin e problematikave të ujit të pijshëm

Së fundmi kemi matur perceptimin e qytetarëve lidhur me vlerësimin e punës së Bashkisë Tiranë në adresimin e problematikave të ujit të pijshëm, nga ku rezulton se: rreth **70%** e të anketuarve vlerësojnë punën e Bashkisë Tiranë në adresimin e problematikave të ujit të pijshëm – **të dobët; 20,8% mjaftueshëm;** dhe vetëm **10% - të mirë**. Analiza e perceptimit të qytetarëve për punën e Bashkisë Tiranë në adresimin e problematikave të ujit të pijshëm nxjerr në pah disa aspekte kritike:

- **Vlerësimi i dobët (rreth 70%):** Kjo shifër e lartë e qytetarëve që e vlerësojnë punën e Bashkisë si të dobët tregon një **vlerësim negativ të qeverisjes lokale** për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e komunitetit. Ky perceptim i dobët mund të jetë rezultat i mungesës së investimeve të duhura në infrastrukturë dhe menaxhimin e resurseve ujore, si dhe pa aftësisë për të ofruar zgjidhje afatgjata për problematikën që prekin furnizimin me ujë.
- **20.8% vlerësim mjaftueshëm:** Një përqindje e tillë tregon se një grup i vogël qytetarësh mund të ketë parë disa përpjekje nga ana e Bashkisë për të adresuar problemet me ujin, megjithatë, ata nuk janë plotësisht të kënaqur. Kjo mund të sugjerojë se ndonjëherë ka ndodhur ndonjë përmirësim, por ai është larg standardeve të nevojshme dhe nuk përmbush pritshmëritë e qytetarëve.

- **Vetëm 10% e vlerësuar si të mirë:** Kjo shifër jashtëzakonisht e ulët tregon se **shumica dërrmuese e qytetarëve** nuk janë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga Bashkia. Kjo mungesë e besimit dhe vlerësimi negativ përfaqëson një thirrje për veprim të menjëhershëm nga autoritetet për të përmirësuar situatën. Kur qytetarët ndihen se zëri i tyre nuk po dëgjohet dhe problemet e tyre nuk po adresohen, kjo ndikon negativisht në klimën sociale dhe besimin në institucionet.

Këto të dhëna sugjerojnë një **nevojë të fortë për reformim dhe angazhim** më të madh nga ana e Bashkisë Tiranë. Një fokus në transparencë, përfshirjen e qytetarëve në procesin vendimmarrjes dhe një strategji të qartë për menaxhimin e burimeve ujore do të ishin hapat e nevojshëm për të adresuar këtë situatë kritike dhe për të rikthyer besimin e qytetarëve.

GJETJET KRYESORE

Mungesa e ujit të pijshëm në Shqipëri, sidomos në Tiranë, është një problem i rëndë që kërkon një qasje sistematike për zgjidhje. Dështimi i institucioneve për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe për të ofruar një shërbim cilësor ka rezultuar në shqetësime të mëdha dhe shpenzime shtesë për familjet. Një ndërhyrje e shpejtë dhe e efektshme, si dhe një angazhim për transparencë dhe komunikim, janë të domosdoshme për të adresuar këtë situatë alarmante.

Mungesa e ujit është një problem i vazhdueshëm, me 32.3% të qytetarëve që raportojnë mungesë prej 2 deri në 4 orë dhe rreth 15% që përfshijnë mungesë më shumë se 8 orë në ditë. Kjo tregon se situata është e rëndë dhe kërkon një ndërhyrje të menjëhershme.

- **Perceptimi mbi Cilësinë e Ujit:** Rreth 80% e qytetarëve e konsiderojnë cilësinë e ujit të pijshëm të dobët. Ky perceptim negativ tregon dështimin e institucioneve për të ofruar një shërbim të përshtatshëm dhe për të përmbushur nevojat e qytetarëve.
- **Pajisja me Depozita:** Rreth 30% e të anketuarve nuk kanë informacion mbi pajisjen e pallateve me depozita, ndërsa 15% raportojnë se pallatet e tyre nuk janë të pajisura. Kjo tregon nevojën

për më shumë transparencë dhe informacion nga autoritetet për të siguruar që qytetarët të jenë të informuar mbi infrastrukturën e ujit.

- **Pastrimi i Depozitave:** Rreth 70% e të anketuarve nuk kanë informacion mbi procesin e pastrimit të depozitave. Kjo nënkupton një nevojë të qartë për edukimin e qytetarëve dhe një sistem të qartë komunikimi nga institucionet për të garantuar cilësinë e ujit.
- **Shpenzimet për Ujin e Pijshëm:** Rreth 97% e të anketuarve shpenzojnë para shtesë për blerjen e ujit të pijshëm, me 53% që shpenzojnë 100-200 lekë në ditë. Kjo tregon se mungesa e ujit dhe cilësia e dobët po detyrojnë qytetarët të përballen me kosto të larta për të siguruar ujë të pastër.
- **Vlerësimi i Punës së Bashkisë:** Rreth 70% e të anketuarve e vlerësojnë punën e Bashkisë Tiranë si të dobët në adresimin e problematikave të ujit të pijshëm. Ky rezultat tregon një humbje besimi të qytetarëve në kapacitetin e autoriteteve për të trajtuar këtë çështje kritike.
- **Informimi mbi Projektet:** Rreth 65.4% e të anketuarve nuk janë të informuar mbi projektet e institucioneve për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm. Kjo tregon se ka një mungesë të madhe në komunikimin dhe transparencën nga ana e institucioneve, që ndikon në besimin e qytetarëve.



REKOMANDIME

1. Rritja e Investimeve në Infrastrukturë:

- Qeveria dhe Ministria e Infrastrukturës duhet të fokusohen në rritjen e buxhetit për sistemet e furnizimit me ujë, duke përfshirë modernizimin e infrastrukturës ekzistuese. Investimet në teknologji moderne dhe në ndërtimin e rezervuareve të reja do të ndihmojnë në sigurimin e një furnizimi më të qëndrueshëm dhe cilësor. Një studim nga Banka Botërore tregon se investimet në infrastrukturën ujore rrisin ndjeshëm aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

2. Transparenca në Informacion:

- Bashkia duhet të implementojë një platformë të dedikuar për informimin e qytetarëve mbi projektet dhe iniciativat e lidhura me furnizimin me ujë. Kjo platformë duhet të përmbajë informacione mbi statusin e projekteve dhe kohezionin me nevojat e qytetarëve, duke ndihmuar në forcimin e besimit të publikut në institucionet.

3. Monitorimi i Cilësisë së Ujit:

- Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë një sistem të rregullt monitorimi të cilësisë së ujit, i cili përfshin teste të rregullta dhe raportime publike. Një strategji e tillë do të ndihmojë në identifikimin e problemeve të mundshme dhe në përmirësimin e përgjigjeve ndaj tyre, siç sugjeron një raport nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

4. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi:

- Qeveria duhet të iniciojë fushata edukative që nxisin qytetarët për të kursyer ujë dhe për të përdorur burimet ujore në mënyrë të qëndrueshme. Këto fushata duhet të përfshijnë informacione mbi efektet negative të konsumit të tepërt të ujit dhe mënyrat se si individët mund të kontribuojnë në ruajtjen e tij.

5. Zhvillimi i Politika të Qëndrueshme:

- Ministria e Mjedisit duhet të hartojë politika të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve të ujit, duke përfshirë masat për të përballuar ndryshimet klimatike. Kjo do të përfshijë projekte për riciklimin e ujit dhe përdorimin e burimeve alternative, siç është ujit e padukshëm, për të garantuar furnizim të vazhdueshëm.

6. Angazhimi i Komunitetit:



- Bashkia duhet të krijojë një forum për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile që të angazhohen në proceset vendimmarrëse lidhur me furnizimin me ujë. Kjo do të sigurojë që nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve të merren parasysh në planifikimin e politikave dhe projekteve.

7. Rritja e Kapaciteteve Administrative:

- Qeveria duhet të investojë në trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative në institucionet që menaxhojnë furnizimin me ujë. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të projekteve dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve.

Implementimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmojë në përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të pijshëm në Shqipëri, duke u siguruar qytetarëve një shërbim më të mirë dhe më të besueshëm.

Shtojcë: Rekomandimet e mëposhtme janë qasje individuale të të anketuarve lidhur me përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të pijshëm në Bashkinë Tiranë.

1. Investime të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësit, përfshirë rinovimin e rrjeteve dhe tubacioneve të vjetra.

(Një infrastrukturë moderne do të lehtësojë transportin e ujit dhe do të reduktojë humbjet, duke siguruar kështu një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë. E rëndësishme është të merret parasysh përdorimi i teknologjive të avancuara për të përmirësuar efikasitetin e sistemit.)

2. Të vendoset një plan detyrues për pastrimin periodik të depozitave në pallate dhe kontrollin e cilësisë së ujit.

(Pastrimi i rregullt do të ndihmojë në ruajtjen e cilësisë së ujit dhe do të reduktojë rrezikun e sëmundjeve. Së pari, duhet të krijohen standarde për kohën dhe mënyrën e pastrimit.)

3. Instalimi i sistemeve filtrimi në nivelin e çdo pallati për të siguruar ujë të pijshëm.

(Filtrat do të ndihmojnë në eliminimin e mbetjeve dhe përmirësimin e cilësisë së ujit. Investimi në teknologji moderne filtrimi është një hap i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e ujit në rrjetin e furnizimit.)

4. Rritja e transparencës dhe komunikimit nga institucionet për përdorimin e fondeve dhe zhvillimin e projekteve për ujë.



(Një komunikim më i mirë do të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe do të sigurojë një angazhim më të madh nga ana e tyre. Kjo do të mundësojë gjithashtu që qytetarët të jenë më të informuar për situatën dhe të kontribuojnë me sugjerime dhe ankesa).

- 5.** Organizimi i fushatave edukative për informimin e qytetarëve mbi rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe përdorimin e tij të sigurt.

(Njohja e qytetarëve me praktikën e mira dhe rreziqet e papastërtisë së ujit do të nxisë një kulturë më të përgjegjshme ndaj burimeve ujore. Edukimi mund të ndihmojë gjithashtu në ndihmën për të ndryshuar sjelljen e konsumatorëve.)

- 6.** Të bëhen kontrole të shpeshta për cilësinë e ujit dhe përmirësimi i sistemit të monitorimit.

(Kontrolli i rregullt është kyç për të siguruar se uji i pijshëm mbetet brenda standardeve të sigurisë. Kjo përfshin implementimin e një sistemi të fuqishëm raportimi dhe përgjegjësie nga institucionet përkatëse.)

- 7.** Qeveria dhe bashkia të marrin masa të menjëhershme për të adresuar këto çështje dhe të përfshijnë qytetarët në vendimmarrje.

(Angazhimi i qytetarëve në procesin e vendimmarrjes do të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve dhe do të sigurojë një qasje më të holistike. Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikimin dhe zbatimin e politikave për ujin është thelbësore për suksesin e projekteve.)

Këto rekomandime kanë si qëllim të adresojnë shqetësimet e shprehura nga qytetarët dhe të ofrojnë një kornizë për përmirësimin e situatës së ujit të pijshëm në Tiranë. Një qasje e integruar dhe e përkushtuar mund të sigurojë që qytetarët të kenë qasje në ujë të pastër dhe të sigurt, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës në kryeqytet.



REFERENCA

ⁱ https://www.gwp.org/globalassets/global/gwp-med-files/list-of-programmes/see-nexus/final-reports/albania-summary-report_final.pdf

ⁱⁱ https://ieg.worldbankgroup.org/sites/default/files/Data/reports/ppar_31626.pdf

ⁱⁱⁱ https://www.gwp.org/globalassets/global/gwp-med-files/list-of-programmes/see-nexus/final-reports/albania-summary-report_final.pdf

^{iv} https://ieg.worldbankgroup.org/sites/default/files/Data/reports/ppar_31626.pdf

^v <https://www.eib.org/en/press/all/2021-435-albania-eib-provides-eur80-million-loan-for-milestone-investments-in-water-distribution-of-the-capital-city>

